VENDIM
Nr. 523, datë 29.7.2022

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 1040, DATË 25.11.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE TË ZBATIMIT TË KRITEREVE TË LEGALIZIMIT DHE MIRATIMIN E MODELIT TË AKTIT TË LEGALIZIMIT PËR NDËRTIMET PA LEJE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 18, pika 4, e 21, pika 3, të ligjit nr. 20/2020, "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 2.1 të vendimit nr. 1040, datë 25.11.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e rregullave të zbatimit të kritereve të legalizimit dhe miratimin e modelit të aktit të legalizimit për ndërtimet pa leje", shtohet pika 2.2, me këtë përmbajtje:

"2.2 Ndërtimi pa leje i ngritur dhe i deklaruar nga institucioni shtetëror qendror/njësia e vetëqeverisjes vendore, në funksion të zhvillimit të veprimtarisë së tij/saj, legalizohet pa iu nënshtruar kritereve të legalizimit të parashikuara në këtë vendim. Për ndërtimin pa leje, për të cilin nuk është paraqitur më parë kërkesë, kërkesa paraqitet nëpërmjet platformës unike qeveritare *"e-Albania"*.

Në funksion të procedurave të legalizimit, institucioni shtetëror qendror/njësia e vetëqeverisjes vendore dorëzon pranë ASHK-së dokumentacionin ligjor, teknik e financiar, që disponon në lidhje me ndërtimin. Pronësia për ndërtimin dhe truallin rregullohet në përputhje me legjislacionin për pronat e paluajtshme të shtetit.".

2. Ngarkohen Agjencia Shtetërore e Kadastrës, institucionet shtetërore qendrore dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama